



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:289408

Datë: 08.10.2020

Numri i dokumentit: 01173121

P.nr.101/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - departamenti i përgjithshëm divizioni penal. si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Adem Shabani dhe zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B., me vendbanim në Rrugën “.... “ në Shtime, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 398 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP /II nr.2122-1/19, dt.31.01.2020, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit F.B. dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av.Faton Neziraj ka mbajtur shqyrtimit gjyqësor fillestar me datën 06.10.2020 të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi , kurse me shkrim e përpiloj me datën 08.10.2020 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F.B., me vendbanim në Rrugën “.... “ në Shtime, i lindur me datën, nga i ati dhe e ëma, e gjinisë , ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës i martuar, babai i një fëmijëve, ka të kryer shkollën fillor me profesion kuzhinier, gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal mbrohet në liri,-.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

- në muajin Mars të vitit 2019, në kohë të pacaktuar në rrugën “Azem Bejta “, në Shtime, i pandehuri ka përdorur patentë shoferi Zviceranë me numër si dokument origjinal edhe pse e ka ditur se nuk është i tillë, të njëjtin e kishte siguruar nga person me emër Xh.... , për të cilin i’a kishte paguar shumë prej 420 euro dhe kishte aplikuar në Qendrën e Aplikimit në Shtime për ndërrimin e patentë shoferit Zvicrës në patentë shofer të Republikës së Kosovës, por pas pranimit të përgjigjes nga autoritetet Zviceranë, është vërtetuar se i pandehuri nuk ka poseduar patentë shofer të Zvicrës, por patentë shoferi ishte i falsifikuar,-

Me të cilën kreu veprën penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 398 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 51, 52 73 DHE 74 të KPRK-së dhe nen. 365 të KPPK-së e:

G J Y K O N

Të akuzuarit **F.B.**, i shqipton DËNIM ME GJOBË, në shumën prej 250 Euro / dyqind e pesëdhjetë euro / i cili dënim do të ekzekutohen 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i akuzuari do të vuaj një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore- paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari dhe taksa në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP /II nr.2122-1/19, dt.31.01.2020 e ka ngarkuar të akuzuarin F.B., me vendbanim në Rrugën "... " në Shtime, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 398 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me datën datën 06.10.2020 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri F.B. dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av. Faton Neziraj.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av.Faton Neziraj në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, kanë pranuar edhe nga një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohe mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari F.B. ne shqyrtimin fillestar, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës dhe

mbështetë në tersi mbrojtjen e tij që e ka dhënë në polici me dt.19.08.2019 dhe në prokurori me datën 30.01.2020, është penduar për veprën penale që i ka kryer kjo është e vërtetë në tersi siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës dhe premtion se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, apo të ngjashme është hera e parë që ndeshet me ligjin dhe kërkon nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit ti merr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit Ajtene Zoni, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi pranimi i tillë është bërë konform ligjit gjegjësisht në bazë të nenit 248 të KPPK-së, dhe ka mbështetje edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike.

I mbrojturi i të pandehurit F.B. me autorizim Av. Faton Neziraj pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim ka kuptuar të gjitha pasojat dhe përparësitë që i njej ligji dhe i njëjti me vullnetin e tij duke u penduar thellë për verimet e tija që i ka ndërmarrë në kryerjen e veprës penale që akuzohet e ka pranuar fajësinë dhe japë mendimin që gjykata ta pranon në këtë fazë të procedurës penale pranimin e fajësisë pasi në tersi mbështetet edhe në deklaratat e tij që me këtë rasti ka dhen në fazat paraprake si në polici dhe në prokurori.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në Raportin e oficerit i datës 23.11.2019, njoftimi i datës 26.04.2019, kërkesë për inicimin e procedurës në emër të pandehurit i dt.15.03.2019, kërkesë për ndërrimin e patentë shoferit të huaj në patentë shofer të Republikës së Kosovës të datës 05.03.2019, përgjigje nga Autoritetet Zvicerane e datës 11.03.2019, dhe provat të tjera që gjendet në shkresat e kësaj lënde penale, e nga të gjitha këto gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprave penale veprës penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 398 par.2 të KPRK-së si në datat, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e parë këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, pendimin e tij për veprat penale të kryera, sjelljen e tij korrekte, se është i martuar, babai i një fëmijëve, i penduar thellë për veprën penale që e ka kryer dhe se ka premtuar se më nuk do të

përsërisë vepra të tilla penale, e në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, dhe në kuptim të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim, si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprave konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor dhe taksës është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës është sjell në bazë nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.101/20 me datë 08.10.2020

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.